



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:139345
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05404612
CAP.nr.1043/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Naim Mehulli, në çështjen përmbartimore të kreditorit: S.K. nga P....., të cilin e përfaqëson Av.Shaban Berisha nga Prizreni kundër debitorit Telekom i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, për borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm CP.nr.1443/2022, të datës 09.06.2023, me datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Telekom i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm CP.nr.1443/2022, të datës 09.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar CP.nr.1443/2022, të datës 09.06.2023, ka vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si i pa bazuar prapësimi i debitorit Telekom i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër aktvendimit të kësaj gjykate CP.nr.1443/2022, të datës 10.11.2022, për lejimin e përmbartimit, dhe i njëjti aktvendim Mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të pranohet e bazuar ankesa e debitorit ashtu që aktvendimi i ankimuar të priset ose lënda të kthehet në rivendosje dhe rishqyrtim ose të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe anulohet i njëjti dhe të vihen jashtë fuqish të gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 07.07.2022, ka ushtruar propozimin për përmbarim, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarimor aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.780/2020 i datës 27.04.2021, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet t'i paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 2172.00 €, në emër të kompensimit të borxhit si dhe ti kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore palës paditëse në vlerë prej 270 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Gjykata e shkallës së parë, me urdhrin përmbarimor CP.nr.1443/2022 të dt.10.11.2022, e ka lejuar propozimin për përmbarim në këtë çështje përmbarimore. Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, në afatin ligjor kanë ushtruar prapësim debitori, duke i ka propozuar që të aprovojë kundërshtimin e debitorit dhe ta anuloj aktvendimin për lejimin e përmbarimit dhe të përfundohet kjo procedurë nën të gjitha veprimet e ndërmarra.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, CP.nr.1443/2022, i datës 09.06.2023 e ka refuzuar prapësimin duke vendosur më decitivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim si dhe shikimit dhe vlerësimit të shkresave, pretendimet prapësuese të debitorit i ka vlerësuar të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj. Kjo pasi që i njëjti nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij, siç është paraparë me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së.

Tutje gjykata ka shtuar se: Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe ato të kreditorit në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi nuk është i bazuar, debitori nuk ka ofruar prova për të argumentuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet e parapara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës. Gjykata ka vlerësuar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren me numër C.nr.780/2020, i datës 27.04.2021, i plotfuqishëm me dt.27.05.2022, i ekzekutueshëm nga data 06.10.2022, në bazë të së cilëve përmbaruesi privat ka zbatuar përmbarimin, janë dokumente përmbaruese dhe përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 21 dhe 24 i LPP-së për të qenë të përmbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përmbarim. Me dispozitën e nenit 21 parashihet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Pra, në rastin konkret këto aktgjykime kanë shërbyer si bazë për lejimin e përmbarimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimi ankimor i debitorit se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, për shkak se dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim të plotë me arsyetimin e aktvendimit, është pretendim tërësisht i pabazuar për faktin se dispozitivi

i aktvendimit është krejtësisht i qartë, i kuptueshëm e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit.

Lidhur me arsyetimin e aktvendimit, gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur me korrektësi dispozitave që përcaktojnë strukturën dhe përmbajtjen e aktvendimit, ndërsa në mënyrë specifike arsyetimi i aktvendimit në vetvete paraqet një përmbajtje koherente me rrjedhë logjike edhe për gjendjen e fakteve të konstatuara nga ana gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përbarues në bazë të cilit është lejuar përbarimi është aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.780/2020, i datës 27.04.2021, i plotfuqishëm nga data 27.05.2022, dhe i ekzekutueshëm nga data 06.07.2022, i cili është dokument përbarues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: “dokument përbarimor është vendimi përbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përbaruese” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: “dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, andaj pretendimet ankimore të debitorëve se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Pretendimet e debitorit për shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përbarimore gjykata me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke ju përmbajtur parimit të rigorozitetit formal-juridik që nënkupton se gjykata do të vlerësoj shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera, pasi që këto pretendime kanë mundur të paraqiten në kohën kur është marrë dokumenti përbarues. Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përbarimit.

Gjykata e shkallës së parë ka lëshuar një gabim teknik që nga koha e lejimit të përbarimit deri në aktvendimin për prapësim, kur në dispozitiv të aktvendimit të atakuar te kreditorit e ka cekur emrin S.K. në vend që të shkruhet S.K., për arsye se emri dhe mbiemri i kreditorit është S.K. kjo vërtetohet nga aktgjykimi i titull përbarimor në këtë çështje e po ashtu nga kartela e llogaris së kreditorit e cila gjendet në shkresat e lëndës, por meqenëse ky gabim teknik nuk ndikon në vendimmarrje kjo gjykata e udhëzon gjykatën e shkallës së parë të bej përmirësimin e emrit të kreditorit para se të vazhdohet me fazën tjetër të përbarimit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitivin e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së (i cili është në fuqi aktualisht, me numër 04 L-139), me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual. Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2022:139345
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05404612

CAP.nr.1043/2023, me datë 04.03.2024

Gjyqtari individual
Naim Mehulli, d.v